



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E MEDIAS**

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

**DREJTUAR BANORËVE TË BASHKISË KAMËZ DHE TË GJITHË PALËVE TË
INTERESUARA.**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “ Për njoftimin dhe konsultimin publik” në nenin 9, pika 1, 3 , të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore neni 18, në rregulloren e Këshillit Bashkiak, për konsultimin publik”.

Titulli i projekt-aktit që hapet për konsultim me publikun:

“RISHIKIM I PLANIT TË INTEGRITETIT 2026-2028 TË BASHKISË KAMËZ”

Ftojme të gjithë grupet e interesit si: banorë të Bashkisë Kamëz , administratorët e njësive dhe lagjeve administrative të Bashkisë Kamëz, ndërlidhës të lagjeve administrative, biznese, grupet e margjinalizuara, të rinj/ të reja, shoqërinë civile, etj., të bëhen pjesë e kësaj dëgjese për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Konsultimi publik do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Datë: 23/07/2026

Ora: 11:00

Vendi: Pallati i Kulturës “Artan Cuku”

Forma e Konsultimit: Dëgjes Publike

Konsultimi publik për Planin e Integritetit ka për qëllim të përfshijë qytetarët, shoqërinë civile dhe grupet e interesit në hartimin e një dokumenti të rëndësishëm strategjik, që synon rritjen e integritetit institucional, parandalimin e korrupsionit, promovimin e sjelljes etike dhe forcimin e transparencës në administratën e Bashkisë Kamëz.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete, të cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme të e-mailit:

-konsultim.publik@kamza.gov.al Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Kjo dëgjese do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë, Njësitë dhe Lagjet Administrative të Bashkisë Kamëz, Anëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak Kamëz.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme.